

Këshilli i Etikës është organ kolegjal i universitetit, që promovon dhe shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor, si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale.

Anëtarët e Këshillit të Etikës zgjidhen me shumicë të thjeshtë votash nga Senati Akademik, nga punonjësit mësimorë me tituj dhe/ose grada, nëpërmjet vetëkandidimit dhe/ose propozimeve të bëra nga vetë Senati Akademik. Anëtarët e Këshillit të Etikës përzgjedhin nga radhët e tyre kryetarin dhe sekretarin e tij. Mandati i anëtarëve të Këshillit të etikës është 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Mbledhjet e Këshillit thirren nga kryetari, i cili si rregull kryeson seancat si dhe përcakton dhe mban rregullin në diskutimin e çështjeve.

Mënyra e shqyrtimit të ankesave, vendimet, sanksionet përkatëse dhe ekzekutimi i këtyre vendimeve, parashikohen në Kodin e Etikës së Universitetit “Fan S. Noli” Korçë.

Këshilli i Etikës së UK-së përbëhet nga 7 anëtarë:

- Një përfaqësues nga çdo njësi kryesore.
- Një përfaqësues i studentëve me mesatare mbi 8.5, i zgjedhur mbi bazën e vetëkandidimit nga Senati Akademik.
- Një përfaqësues nga personeli ndihmës mësimor dhe administrativ.
- Një përfaqësues nga Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore.